



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 341 Prot.

Tiranë, më datë 08.07.2026

VENDIM

Nr. 235, datë 08.07.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i ndryshuar, neni 38, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.07.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e Konceptit të gërmimit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i shkollës së mesme ‘Gjergj Kastrioti’ 3, 4 dhe 5 kate dhe 1 kat nëntokë”, në pasurinë nr. 25/186, zona kadastrale 8512 me vendndodhje rruga “Nako Spiro”, njësia strukturore dr_ub_asl_480/109, me zhvillues **Bashkia Durrës**;
2. Projekti “Ndërtimi i shkollës së mesme ‘Gjergj Kastrioti’ 3, 4 dhe 5 kate dhe 1 kat nëntokë”, në pasurinë nr. 25/186, zona kadastrale 8512 me vendndodhje rruga “Nako Spiro”, njësia strukturore dr_ub_asl_480/109, me zhvillues Bashkia Durrës, do të realizohet pas përfundimit të gërmimit arkeologjik të Zonës 1, e cila përkon me gjurmën e propozuar për ndërtimin e shkollës.
3. Rezultati i gërmimeve arkeologjike duhet të vijojë për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM);
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

